



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VIII  
Sesioni Pranveror  
Kryesia e Kuvendit  
P-054

Prishtinë, më 16 janar 2023, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 16 JANAR 2023**

**Në mbledhje morën pjesë:** Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit.

**Mungoi:** Nënkryetari i Kuvendit, Bekim Arifi.

**Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë:** Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Arben Gashi, Pal Lekaj dhe Enis Kervan.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:** Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme,
3. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

## **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 16 dhjetor 2022**

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 16 dhjetor 2022.

## **2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme**

Pas diskutimeve, kryetari me konsensus vendosi për vazhdimin e tri (3) seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që të mbahet të mërkurën, më 18 janar 2023, në orën 10:00, me këtë:

*Rend dite*

### **I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 14 tetor 2022:**

- 12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-172 për sigurinë e përgjithshme të produkteve,*
- 13. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës në lidhje me mosrealizimin e projekteve kapitale të Qeverisë gjatë vitit 2022,*
- 14. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,*
- 15. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2021.*

### **II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 15, 22, 23 shtator 2022:**

- 9. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-123 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive ekzekutive,*
- 10. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-147 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti,*
- 11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2021,*
- 12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2021,*
- 13. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2020,*
- 14. Shqyrtimi i raportit me rekomandime nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-003 për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës,*
- 15. Shqyrtimi i raportit me rekomandime nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë,*
- 16. Shqyrtimi i rekomandimeve të dala nga shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Universitetit të Prishtinës për vitin 2021.*

### **III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 7, 24 tetor dhe 18 nëntor 2022:**

- 8. Votimi i Propozim-rezolutës për gjendjen në sektorin e shëndetësisë,*
- 9. Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2021,*
- 10. Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës për vitin 2021.*

Ndërsa, nuk u vendos për vazhdimin e seancave tjera, me pikat e papërfunduara.

Po ashtu, në lidhje me pikat e papërfunduar të disa seancave, kryetari deklaroi se Kuvendi i Republikës së Kosovës do të mbajë vazhdimet e seancave çdo të mërkure, ndërsa çdo të enjte do të mbajë seancat e reja plenare.

Ndërsa njoftoi se javën pasuese nuk do të mbahet asnjë seancë, ngase ai dhe nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, do të shkojnë në një vizitë zyrtare në lidhje me aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

### **3. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës**

Kryetari, pas diskutimeve për rendin e ditës të propozuar për seancë plenare, me miratimin e tij me konsensus vendosi që seanca plenare e radhës e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të enjten, më 19 janar 2023, në orën 10:00, me këtë:

#### *Rend dite*

- 1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
- 2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
- 3. Pyetjet parlamentare,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-178 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin nr. 04/L-168 dhe Ligjin nr. 05/L-116,*
- 5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,*
- 6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2021,*
- 7. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në ndërmarrje publike.*

Pika nr. 4: Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-178 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin nr. 04/L-168 dhe Ligjin nr. 05/L-116 u radhit në rendin e ditës të seancës plenare me propozim të kryetarit të GP të PDK-së, Abelard Tahiri.

Zoti Tahiri e arsyetoi propozimin e tij, ngase Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, si komision funksional e ka shqyrtuar Projektligjin e lartshënuar, por që ende nuk e ka proceduar Raportin me rekomandim.

Pastaj, ai e njoftoi Kryesinë e Kuvendit se përfaqësuesi i nismës qytetare të këtij projektligji e ka autorizuar deputetin Bekim Haxhiu që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin e lartshënuar në seancë plenare.

Diskutimi i plotë i kryetarit të GP të PDK-së, Abelard Tahiri është dhënë në transkript.

#### **4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave**

##### *1. Njoftim në lidhje me zbatimin e Ligjit nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik*

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, e njoftoi Kryesinë e Kuvendit se në lidhje me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik, Administrata e Kuvendit është e shqetësuar me statusin dhe kompensimet në raport me punën që e bën në Kuvend, si dhe me pasqyrën e pranuar nga Ministria e Punëve të Brendshme është evidente se Administrata e Kuvendit është e hendikepuar në statusin aktual, si në paga, ashtu edhe në shtesa.

Ai shtoi se është përgatitur një draft-vendim për miratim nga Kryesia e Kuvendit, por pas një diskutimi me kryetarin e Kuvendit është arritur dakordim që së bashku me nënkryetarët e Kuvendit të përgatitet një draft i aktit sipas Rregullores së Kuvendit, që ka të bëjë me klasifikimin e pozitave dhe koeficientet e shërbyesve civilë në Administratën e Kuvendit të Kosovës.

Diskutimi i plotë i Sekretarit të Kuvendit, Ismet Krasniqi, është dhënë në transkript.

Në vazhdim, Kryesia u njoftua me një kërkesë nga zyrtarët e Shërbimit të Deputetëve në lidhje me pozitën e tyre.

Më pas, në lidhje me zbatimin e Ligjit nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik dhe statusin e zyrtarëve të shërbimit civil të Kuvendit të Kuvendit diskutuan: kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi; kryetarja e GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila dhe kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, diskutimet të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia në lidhje me klasifikimin e pozitave të nëpunësve civilë të Administratës së Kuvendit sipas Ligjit nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Kërkohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që ta hartojë Propozim-rregulloren për strukturën organizative dhe klasifikimin e pozitave të nëpunësve civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Klasifikimi i pozitave të nëpunësve civilë të Administratës së Kuvendit nënkupton: Kodin e vendit të punës; Emërtimin e vendit të punës, Kategorinë funksionale; Klasën e vendit të punës; Koeficientin; Numrin e pozitave, Kualifikimin dhe Përvojën e punës.
3. Për klasifikimin e pozitave nga pika 2 e këtij përfundimi të merren për bazë detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësve civilë të Administratës së Kuvendit.

4. Propozimi-rregullorja nga pika 1 e këtij përfundimi i procedohet Kryesisë së Kuvendit për mbledhjen e radhës, më 20 janar 2023.

*2. Kërkesa e z. Driton Selmanaj, kryesues i Komisionit Hetimor Parlamentar, lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për procedimin e Draft-raportit të punës së këtij komisioni hetimor për diskutim dhe miratim në seancë plenare*

Kryetari i njoftoi të pranishmit se kryesuesi i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Driton Selmanaj, ka kërkuar procedimin e Draft-raportit të punës së këtij komisioni hetimor për diskutim dhe miratim në seancë plenare.

Ai tha se sipas kërkesës, ky komision hetimor nuk e ka miratuar raportin e vet.

Kryetari po ashtu dha sqarime nga Ligji nr. 03/L-176 për hetim parlamentar në lidhje me miratimin dhe procedimin e raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar, i cili brenda mandatit duhet të miratohet nga komisioni hetimor, e pastaj të procedohet për shqyrtim në seancë plenare.

Diskutimi i plotë i kryetarit të Kuvendit është dhënë në transkript.

Më pas, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, diskutuan: kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi; kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca; kryetarja e GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila, dhe kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari me konsensus vendosi që shqyrtimi i raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës të radhitet në rendin e ditës të seancës plenare të radhës.

*3. Kërkesa e Komisionit ad hoc për Zhvillimin e Procesit të Vlerësimit Kalimtar për ndarjen e buxhetit për këtë komision ad hoc*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Komisionit ad hoc për Zhvillimin e Procesit të Vlerësimit Kalimtar i ndahet buxheti në shumën prej 5 000 (pesëmijë) euro.

*4. Kërkesa për aprovimin e mëditjeve nga udhëtimi zyrtar në Shqipëri*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Albana Bytyqi, i kompensohen mëditjet nga udhëtimi zyrtar në Tiranë (Shqipëri), nga data 15 deri më 17 dhjetor 2022.

*5. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve nga udhëtimi zyrtar në Belgjikë*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Floretë Zejnullahu, i mbulohen të gjitha shpenzimet dhe i kompensohen mëditjet nga udhëtimi zyrtar në Bruksel (Belgjikë), nga data 6 deri më 8 dhjetor 2022, sipas kërkesës nr. 08/3262/Do-1364, datë 23. 12. 2022.

*6. Kërkesa për ndryshimin e datave të udhëtimit dhe mbulimi i shpenzimeve të transportit nga udhëtimi zyrtar në Paris (Francë)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Arben Gashi, i miratohet ndryshimi i datave të udhëtimit zyrtar në Paris (Francë), nga datat 11-14 dhjetor 2022, të lejuara me Vendimin nr. 08-V-336, në datat 10-14 dhjetor 2022, si dhe i mbulohen shpenzimet e transportit me taksë në shumën prej 228,60 euro të bëra gjatë realizmit të këtij udhëtimi zyrtar.

*7. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për biletën shtesë nga udhëtimi zyrtar në Turqi*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fidan Jilta, i kompensohen shpenzimet shtesë për blerjen e biletës së re kthyese në vlerën prej 407,99 euro të bëra gjatë realizmit të udhëtimit zyrtar në Turqi, nga data 18 deri më 20 dhjetor 2022.

*8. Kërkesa për emërimin e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës për vitin 2023*

Kryetari i njoftoi të pranishmit se duhet të deklarohet dhe caktohet ky delegacion në baza vjetore dhe kërkoi nga nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, për ta sqaruar më shumë këtë delegacion.

Nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, i njoftoi të pranishmit se është arritur pajtim që edhe për vitin 2023 të jetë i njëjti delegacion, ndërsa një pozitë e zëvendësanëtarit ka mbetur e zbrazët pasi që deputetët e Listës serbe nuk janë përgjigjur për ta propozuar një deputet në këtë delegacionit, diskutimi i plotë i secilës është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari deklaroi se ai do ta njoftojë kryetarin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për përbërjen e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në këtë Asamble Parlamentare për vitin 2023.

*9. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për koktejin e organizuar për festat e fundvitit me organizatat partnere që e mbështetin punën e Kuvendit të Kosovës*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

Mbulohen shpenzimet në shumën prej 994 euro, sipas faturës për koktejin e organizuar nga kryetari i Kuvendit, më 23 dhjetor 2022, për institucionet ndërkombëtare dhe partnere që e mbështetin punën e Kuvendit të Kosovës.

*10. Kërkesat për lejimin e udhëtimeve zyrtar në Uashington D.C. (SHBA)*

Në lidhje me kërkesat e deputetëve: Ramush Haradinaj, Besnik Tahiri, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Enis Kervan, Gazmend Gjyshinca dhe Blerta Deliu-Kodra për lejimin e udhëtimeve zyrtar në Uashington (Shtetet e Bashkuara të Amerikës) për pjesëmarrje në Lutjet e Mëngjesit, kryetari propozoi që të bëhet një standardizim, që përmes grupeve parlamentare të caktohen nga një përfaqësues për pjesëmarrjen në këto Lutje të Mëngjesit.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Më pas, në lidhje me kërkesat e lartshënuara dhe propozimin e kryetarit diskutuan: nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci; përfaqësuesi i GP të AAK-së - deputeti Pal Lekaj, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, dhe kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia në lidhje me kërkesat e lartshënuara për lejimin e udhëtimeve zyrtare në Uashington D.C. (SHBA) nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që në lidhje me lejimin e pjesëmarrjes së deputetëve në Lutjet e Mëngjesit në Uashington D.C. (Shtetet e Bashkuara të Amerikës) më 1 dhe 2 shkurt 2023, të propozojnë vetëm nga një (1) përfaqësues nga secili grup parlamentar, dhe atë me

përfaqësim nga kryetarët e subjekteve (partive) parlamentare, kryetarët e grupeve parlamentare, nënkryetarët e Kuvendit, ose deputetët që caktohen nga grupi parlamentar.

Po ashtu, kryetari deklaroi se në lidhje me kohëzgjatjen e udhëtimeve zyrtare, Kuvendi i Kosovës nuk do ta mbulojë asnjë shpenzim më shumë se një ditë para dhe një ditë pas datave sa zgjat vizita zyrtare.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

#### *11. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Abu Dhabi (Emiratet e Bashkuara Arabe)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fitore Pacolli-Dalipi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Abu Dhabi (Emiratet e Bashkuara Arabe), prej 14 deri më 19 janar 2023.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

#### *12. Njoftimi i kryetares së Komisionit për Integrim Evropian lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Pragë (Çeki)*

Kryetarja e Komisionit për Integrim Evropian, Rrezarta Krasniqi, e ka njoftuar me shkrim Kryesinë e Kuvendit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Pragë (Çeki), prej 13 deri më 6 nëntor 2022.

#### *13. Raporti i punimeve të Seminarit të 102-të Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s*

Kryesuesi i Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asambleshë Parlamentare të NATO-s, Driton Hyseni, Kryesisë së Kuvendit ia ka paraqitur raportin e punimeve të Seminarit të 102-të Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili është mbajtur në Republikën e Kosovës, prej 8 deri më 10 tetor 2022.

#### *14. Raporti i punimeve të Sesionit Vjeshtor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s*

Kryesuesi i Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asambleshë Parlamentare të NATO-s, Driton Hyseni, Kryesisë së Kuvendit ia ka paraqitur Raportin nga pjesëmarrja e këtij Delegacioni në punimet e Sesionit Vjeshtor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili është mbajtur në Spanjë, prej 18 deri më 21 nëntor 2022.



*15. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Stokholm (Suedi)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rrezarta Krasniqi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Stokholm (Suedi), prej 28 deri më 31 janar 2023.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në fund, përfaqësuesi i GP të AAK-së - deputeti Pal Lekaj e shtroi çështjen e angazhimit të këshilltarëve për deputetë, siç është e përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit, diskutimi i të cilit i plotë është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar të shtruar nga z. Lekaj, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, i njoftoi të pranishmit se është duke u finalizuar një draft i udhëzimit përkatës për këtë çështje, për të cilin, sipas Rregullore së Kuvendit, vendos Kryesia e Kuvendit, diskutimi i të cilit i plotë është dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen në orën 12:10 minuta.

Glauk KONJUFCA

---

Kryetar i Kuvendit

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*